



DARDANIA
INSTITUCION I ARSIMIT UNIVERSITAR

**Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / Sudski Savet Kosova
KOLEGJI DARDANIA FAKULTETI JURIDIK NË PRISHTINË**

Më këtë memorandum të mirëkuptimit (më tutje: memorandum), Këshilli Gjyqësor i Kosovës i përfaqësuar nga z. Enver Peci, kryesues dhe Kolegji Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë i përfaqësuar nga Prof. Dr. Ejup Sahiti, Dekan me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë në sferën e mësimit teorik dhe praktik të studentëve, lidhin këtë:

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandum është lehtësimi dhe organizimi i qasjes së studentëve të Kolegjit Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë në Gjykatat Themelore në Kosovë për avancim të njohurisë praktike të tyre për çështjet juridiko-gjyqësore.

Neni 2

Obligimet e Gjykatave Themelore në Kosovë

Gjykatat zotohen se do t'i mundësojnë përcjelljen e gjykimeve të ndryshme studentëve të Kolegjit Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë me përjashtim të atyre gjykimeve, të cilat sipas ligjit në fuqi nuk lejohet pjesëmarrja e publikut si dhe do t'i koordinojnë aktivitetet e studentëve në gjykata si për shembull simulimet e gjykimeve, funksionimin e Zyrës Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve, pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, etj.

Neni 3

Obligimet e Kolegjit Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë

Kolegji Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë zotohet se do të organizojë orarin e vizitave të studentëve në gjykatë në mënyrë që të gjithë studentët të kenë qasje sipas interesave të tyre. Kolegji Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë zotohet se do ta njoftojë gjykatën mbi orarin e vizitave dhe listën e studentëve së paku një (1) muaj më herët.

Kolegji Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë zotohet se do të koordinojë punën me gjyqtarë të cilët janë caktuar si koordinator për të garantuar se puna me studentë në gjykatë të vlerësohet dhe konsiderohet si pjesë e mësimi të tyre.

Neni 4 Amandamentimet

Çfarëdo ndryshimi në përbërje, synime, objektiva, veprimtari apo afate do të marrë miratimin e ndërsjellë të të gjitha palëve nënshkruese.

Palët do të përpiqen që të gjitha mosmarrëveshjet t'i zgjidhin në bazën e mirëkuptimit të përbashkët dhe në partneritet sa i përket objektit të këtij memorandumi.

Neni 5 Zgjidhja e konflikteve

Në rast të konfliktit në interpretim të këtij memorandumi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kompetent për zgjidhjen e konfliktit, respektivisht interpretimin e këtij memorandumi.

Neni 6 Nënshkrimi i Memorandumit

Ky Memorandum përpilohet dhe nënshkruhet në tre (3) kopje identike, nga të cilat secila palë mban nga një (1) ekzemplar, dhe një ekzemplar i dorëzohet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e të gjitha palëve nënshkruese dhe vlen deri në momentin e shkëputjes së tij me pajtimin e palëve ose në mënyrë të njëanshme nga cilado palë nënshkruese me paralajmërim prej tridhjetë (30) ditëve.

Me pajtim të plotë, palët nënshkruese, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e nënshkruajnë këtë memorandum mirëkuptimi me 21 maj 2015.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Enver Peci, Kryesues



Kolegji Dardania - Fakulteti Juridik në Prishtinë

Prof. Dr. Ejup Sahiti, Dekan